



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISE KULTURORE

**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore**

**TITULLI I LËNDËS: EPOKA E BRONZIT NË EGJE**

**Pedagogu:** Prof. Asoc. Dr. Lorenc Bejko  
**Ngarkesa:** 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)  
**Lloji i lëndës:** lëndë me zgjedhje  
**Programi i studimit:** bachelor  
**Viti/Semestri:** III/I

#### **EKSTRAKT**

Lënda synon që nëpërmjet diskutimit të thelluar dhe të ilustruar gjerësisht, të trajtojë problematikën më të gjerë të preiudhës prehistorike në pellgun e Egjeut. Zhvillimet me karakter arkeologjiko-historik në këtë rajon kanë një rëndësi të madhe jo vetëm se çuan në lindjen dhe zhvillimin e formave më të hershme të qytetërimit Mesdhetar, por edhe sepse ndikuan fuqishëm kulturën materiale dhe ndryshimet shoqërore edhe në komunitetet prehistorike të territorit tonë. Të dhënat e pasura arkeologjike janë organizuar mbi bazë territoriale dhe përmbledhin rajonet e Greqisë kontinentale (Helladiku); ishujt e Egjeut (përveç Kretës) (Cikladiku); Kretën (Minoiku); dhe territorin e Azisë së Vogël.

Zhvillimi i kulturës materiale ndiqet në tre fazat kryesore të epokës së Bronzit (i hershëm, i mesëm dhe i vonë), por shtrihet edhe në epokat më të hershme të Paleolitit dhe Neolitit duke përfshirë edhe materialin e ri të zbuluar gjatë viteve të fundit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet diskutimit të terive dhe shkaqeve që çuan në linden e qytetërimit të hershëm pallator në Kretë dhe Mikenë, si dhe rolit të këtyre qendrave në zhvillimet rajonale. Teoritë për spjegimin e shkaqeve të rënies së këtyre qytetërimeve janë gjithashtu të një rëndësie të veçantë dhe do të debatohen gjerësisht në klasë.

Pjesa e fundit e lëndës do të synojë të diskutojë transformimin shoqëror dhe kulturor në periudhën e Hekurit të hershëm në Egje dhe shkaqet e këtyre ndryshimeve. Përgatitja e kushteve për rilindjen e formave urbane të jetesës në shekullin e 8të p.e.s. do të përbëjë gjithashtu një pjesë të rëndësishme të diskutimit.

**TEMAT:**

**LEKSION 1.** Hyrje: qëllimi dhe struktura.

**LEKSION 2.** Terminologjia dhe kronologjia.

**LEKSION 3.** Sekuenca Paleolitike dhe Mezolitike: shpella Frankthi.

**LEKSION 4.** Kulturat neolitike në Thesali, Kretë dhe Ciklade.

**LEKSION 5.** Helladiku i hershëm: grupet kulturore “Korakou”, “Eutresis” dhe “Lefkandi”.

**LEKSION 6.** Minoiku i hershëm: vendbanimet dhe varrezat.

**LEKSION 7.** Bronzi i hershëm në Anatinë perëndimore dhe Egjeun lindor.

**LEKSION 8.** Helladiku dhe Minoiku i mesëm: sistemi i hershëm i pallateve në Egje.

**LEKSION 9.** Arkitektura Minoike: pallatet, arkitektura rezidenciale dhe ajo funerale.

**LEKSION 10.** Arti dhe organizimi shoqëror në periudhat proto-, neo-, dhe post-palaciale.

**LEKSION 11.** Bronzi i vonë dhe lindja e qendrave pallatore mikene në Peloponez.

**LEKSION 12.** Arkitektura, shkrimi Linear B dhe kultura materiale mikene.

**LEKSION 13.** Teoritë për shkaqet e rënies së sistemit të pallateve në Mikenë.

**LEKSION 14.** “Dark Age” dhe zhvillimet historiko-kulturore në epokën e Hekurit në Egje.

**LEKSION 15.** Periudha Arkaike dhe lindja e polisit si formë e re shoqërore.

**FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT****FREKUENTIMI:**

70% pranishë në seminare e domosdoshme.

*15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve*

**KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

*25 % e notës përfundimtare.*

**DETYRA E KURSIT:**

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Nëë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

*20 % e notës përfundimtare*

**KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

*40 % e notës përfundimtare*

**DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN**

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

**LITERATURA:**

1. Chadwick, J. 1976 *The Mycenaean world*. Cambridge, Cambridge University Press.
2. Dickinson, O. 1994 *The Aegean Bronze Age*. Cambridge, Cambridge University Press.
3. Dickinson, O. 2007 *The Aegean from Bronze Age to Iron Age*. Routledge, London and New York.
4. Harding, A. 2000 *European societies in the Bronze Age*. Cambridge, Cambridge University Press.
5. Kristiansen, K. dhe T. Larson 2005 *The rise of Bronze Age society: travels, transmissions and transformations*. Cambridge, Cambridge University Press.
6. Osborne, R. 1996 *Greece in the making (1200-479 BC)*. Routledge, London and New York.
7. Rutter, J. 1995 *The Aegean Bronze Age*. Series of lectures at [http://projects.dartmouth.edu/history/bronze\\_age/](http://projects.dartmouth.edu/history/bronze_age/)
8. Sandars, N. K. 1987 *The Sea Peoples: warriors of the ancient Mediterranean*. Thames and Hudson, London.
9. Snodgrass, A. 1987 *An archaeology of Greece: the present state and future scope of a discipline*. University of California Press, Berkeley–Los Angeles–London.
10. Snodgrass, A. 2001 *The Dark Age of Greece*. Routledge, New York.